

# H Y L L I I D R I T Ë S

## E P Ë R K O H S H M E K U L T U R A L E - L E T R A R E

---

### 1. PORTRETE & KULTURË

**Michael Schmidt-Neke**

*Dy disidentë në përleshje rreth çështjes shqiptare: Mary Edith Durham dhe Hermann Wendel* 5

**Tomor Osmani**

*Gaspër Mikeli - hartues tekstesh shkollore* 16

**Albert Riska**

*Shën Gjini - për origjinën e emrit të shenjtorit* 27

**Ina Arapi**

*Arbëria në fund të shek. XVII dhe lidhjet me popujt fqinjë sipas veprës "Çeta e profetëve" të arqipeshkvit Pjetër Bogdanit (1685)* 35

**Dhori Qiriazi**

*Hapa të hershëm të Thimi Mitkos për një shqipe të përbashkët* 45

### 2. LETËRSI & KRITIKË LETRARE

**Shaban Sinani**

*Dall'illusione alla disillusione, dall'allusione alla dissidenza* 61

**Eriona Tartari**

*Migjeni dhe poetika e tij: Nga romantizmi tek realizmi si një frymëmarrje e letërsisë moderne* 81

### 3. GJUHËSI & FILOLOGJI

#### **Kolec Topalli**

*Thesaret gjuhësore të së folmes së Hotit në një fjalor etimologjik* 93

#### **Larisa Kaminskaya**

*Disa vërejtje mbi leksikun e shqipes në fjalorin e Pallasit (1787-1789)* 101

#### **Mimoza Kore**

*Veçori gjuhësore të "Djalit plangprishës" në të folmen e Gjirokastrës* 108

#### **Gianni Belluscio**

*Notizie inedite per la biografia di F. A. Santori in alcune sue lettere a G. De Rada* 116

#### **Evalda Paci**

*Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe – Zotynë si rast studimi* 129

#### **Bardhyl Demiraj**

*Mallkimet që lëshon ipeshkvi të Enjten e Madhe (1744 ?)* 140

#### **Pëllumb Xhufi**

*"Et pestilentia venit": një vështrim mbi murtajën në Shqipëri* 163

### 4. ARKIVI I HYLLIT

#### **Martin Camaj**

*Çashtja kosovare* 176

### 5. RECENSIONE

Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj* (Botim i dytë i ripunuar - përgatitur nga Bardhyl Demiraj), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Editions ONUFRI, Tiranë 2013 – përgatiti Seit Mansaku 183

Matteo Mandalà, *Lekë Matranga. Njeriu, koha, vepra. Me botimin kritik të varianteve dorëshkrim- përgatiti e të shtypur të veprës E mbsuame e krështerë (1592), Ombra GVG, 570 f., Tiranë 2013 – përgatiti Anila Omari* 188

Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Bleu V (K-M), SHB Çabej, 478 fq., Tiranë 2014 – përgatiti Bardhyl Demiraj 194

Bardhyl Demiraj, *Shqiptar dhe shqa. Histori popujsh përmes dy emrave etnikë*, Naimi, 248 f., Tiranë 2014 – përgatiti Anila Omari 200

## 6. NEKROLOGJI

*Ndahet nga jeta akademik Shaban Demiraj* – përgatiti Seit Mansaku 207

## 7. KRONIKË

### **Ema Kristo & Veton Matoshi**

Tubimi i 5-të Kulturor-Shkencor „Gjuhë dhe kulturë e shqiptarëve – në dimensionet kohë dhe hapësirë“ (Buçimas, 5-9 qershor 2014) 208

### **Mehmet Kraja**

Pamje e zyrtë e Kosovës 227

## Mallkimet që lëshon ipeshkvi të Enjten e Madhe (1744 ?)

Në këtë trajtë të standardizuar titullojmë studimin tonë, duke përshtatur kështu titullin burimor të tekstit të vjetër shqip <Małekimet chi lescion Vpesckepi Teinten Emaže>, të cilin e trashëgojmë prej fondit letrar të arealit kulturor të Veriut. Ky tekst, në fakt, është bërë i njohur ngamot për lexuesit specialistë, qysh në vitin 1958, kur studiuesi Kolë Kamsi përpos kumtit fatlum mëngoi me përshtatur rrethanat e përfatimit të tij, madje edhe me përcjellë në debatin albanologjik një tejskrim diplomatik të tekstit me aparat filologjik përkatës (Kamsi 1958 210vv.)<sup>1</sup> Fat të pafat përjetuan në të kundërtën shënimet dhe tejskrimi pas gjase i mëhershëm i Gjush Sheldisë (1957-58 66v.) që erdhën e iu bënë të njohura rrethve letrare-intelektuale thujse gjashtë dekada më pas.<sup>2</sup> Pavarësi në hetim mëton edhe Nevila Nika (2001 132v., 222 vv.),<sup>3</sup> e cila e përshkruan këtë tekst nga perspektiva e historianes së arkivave, ndërkohë që vëzhgimet filologjike përgjithësuese të Dhimitër Shuteriqit (2005 266v.)<sup>4</sup> dhe Tomor Osmanit (2008 99vv.)<sup>5</sup> plotësojnë më së miri rrethin e atyre studiuesve që janë marrë drejtpërdrejt ase tërthorazi me këtë tekst deri sot.

Përmblohdhëm kështu që në hyrje të punimit tonë historikun e zbulimit të tekstit dhe aradhën e atyre studiuesve që janë marrë ndërkohë me të. Dëshira jonë për t'iu bashkuar këtij rrethi studiuesish ka të bëjë në radhë të parë me analizën e mirëfilltë filologjike të tekstit, meqë rezulton si i vetmi tekst në arealin kulturor të Veriut, i cili nuk

1 Kolë Kamsi: Një dokument gjuhësor shqip dhe disa vjersha e materiale gjuhësore të kolonive arbëreshe të Kalabrisë e të Basilikatës, në BUSHT SSHSH 2 [1958] 210vv.

2 Material i mbetur në dorëshkrim prej tij, por që u përgatit dhe botua në Shkodër nga Koleç Çefa me titull: “Kryepeshkvia metropolitane e Shkodrës e dioqezat sufragane. Shënime historike”. Viti i botimit 1957-1958 – i dhënë në ballinë – është fiktiv dhe ka të bëjë pas gjase me periudhën e hartimit të tij nga autori, i cili, siç rezulton edhe nga parathënia e dikurshme e Ipeshkvit Ernest M. Çoba (dt. 19 prill 1958): “pat mirësinë me ia dhurue Klerit katolik shqiptar ...” (f. 5).

3 Nevila Nika: Dioqeza e Shkodrës gjatë shek. XVIII sipas dorëshkrimeve arkivore, Shkodër 2001.

4 Dhimitër Shuteriqi: Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800, Tiranë 2005<sup>2</sup>. Në këtë shkrim Shuteriqi falënderon shprehimisht Willy Kamsin për konsultën e zhvilluar më parë me të.

5 Tomor Osmani: Udhë e shkronjave shqipe. Histori e alfabetit, Tiranë 2008<sup>2</sup>.

u është nënshtruar ende parametrave të sotëm metodikë në punën filologjike me shkrimet e vjetra shqip. Një analizë e tillë sigurisht që mundëson edhe saktësimin e vendit të tij në historinë e kulturës së shkrimit shqip, ndërkohë që njohja dhe hetimi i materialit burimor në fondet e Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH)<sup>6</sup> na lejon tash të pjesëmarrim në mënyrë aktive në debat, sa i përket kohës së hartimit e në bashkëlidhje me të edhe të autorësisë së tekstit. Janë këto dy hallka themelore në vetë historinë e tekstit, për të cilat – edhe pse studiuesit janë thujse në unison – ende nuk mund të mëtohet se është thënë fjala e fundit.

## 1. Shtjellime paratekstuale

### 1.1 Rrethanat e zbulimit, vendndodhja dhe variantet e tekstit

Kolë Kamsi mjaftohet në shënimet e tij hyrëse (1958 210) të kumtojë vendndodhjen e tekstit atëbotë në arkivin e Ipeshkvisë së Shkodrës, i cili rrugëtoi për arsye tashmë të njohura drejt AQSH-së, ku gjithsesi ruhet e mirëmbahet sot e gjithë ditën në kushte optimale. Teksti vetë është i përfshirë si i tillë në bleun e dytë – por të vetëm – të të ashtuquajturit “regjistër” i zyrës famullitare të Tophanës me signaturë: A.Q.SH. i R.SH. F.132/a, V.1744, D.1.

Mungesa e bleut të parë si edhe e faqes apo faqeve të para të këtij bleu të dytë i vështirësojnë saktësimet e nevojshme në përshkrimin të tij.<sup>7</sup> Materialet e përfshira në të përforcojnë gjithsesi një përshtypje të parë se kemi të bëjmë me një lloj almanaku shkrimesh nga më të ndryshmet, të cilat janë hedhur në letër nga duar po aq të ndryshme përgjatë një periudhe bukur të gjatë: vitet 1744/45 – 1831. Një farë sistematike në konceptimin zanafillës konsiston deri diku në hapësirat që u janë lënë tematikave të shkrimeve përkatëse. Kështu p.sh. në një pjesë të parë (fol. 1 – 25) janë përfshirë kryesisht kopje pjesësh relacioni të ndonjë vizite apostolike, kopje aktesh ose dekretesh sinodale, sikurse edhe kopje letërkëmbimi e referencash të ndryshme. Pas një hapësire bosh prej rreth 70 foljesh pasojnë lista regjistrimi të mirëfilltë pagëzimesh, krezmimesh dhe martesash për besimtarët e asaj dioqeze.

Teksti ynë është përfshirë bash në pjesën e parë të “regjistrit”, duke

<sup>6</sup> Dëshiroj t’u shpreh këtu falënderimet e rastit dy drejtorëve të AQSH-së, Nevila Nika dhe Gjet Ndoj, të cilët patën mirësinë të më vinin secili në dispozicion të gjithë materialin arkivor përkatës.

<sup>7</sup> Siç pohon edhe Nevila Nika: “Regjistrat [ndër ta edhe regjistri në fjalë – B.D.] janë të lidhura relativisht mirë. Kapakët janë prej lëkure bojë kafë dhe njëkohësisht edhe me kapak kartoni të brendshëm. Letra e përdorur është mjaft e mirë [...] Boja e shkrimit gjithashtu e përdorur ka qenë e një cilësie shumë të mirë. Përdorur më tepër se 250 vjet më parë ajo i ka rezistuar kohës [...]” (vep. cit. f. 4). Mund të shtojmë gjithashtu se formati i letrës gëzon përmasat 28,5 cm. x 19,5 cm.

filluar në f. 11 (= fol. 7r), së pari në variantin italisht. Në vijim – në mes të f. 12 (= fol. 7v) – ndjek menjëherë edhe varianti shqip, i cili përfundon në gjysmën e sipërme të f. 14 (= fol. 8v). Do shtuar këtu se variantit italisht [= var. A] i paraprin një ekstrakt prej relacionit të zgjeruar të vizitës apostolike që zhvilloi në gjysmën e dytë të vitit 1702 në Provincën Kishtare të Arbënit si edhe në Arqipeshkvinë e Shkupit arqipeshkvi i Tivarit, Imz. Vinçenc Zmajeviq (= <Vincenz Zmaieuich>),<sup>8</sup> ndërsa variantin shqip [= var. B1] e pasojnë menjëherë në vazhdim (fol. 8v) aktet italisht të sinodit të vitit 1704 që thirri atëbotë në Beltojë ipeshkvi i Shkodrës Imz. Ndue Babi (= <Antonio Babbi>).<sup>9</sup> Lidhur me historinë e tekstit tonë vlen të shënojmë paraprakisht që këto tri tekste janë shkruar nga e njëjta dorë dhe që si i pari ashtu edhe i treti janë pa dyshim kopjime materialesh burimore, ndër të cilët i pari mund të identifikohet lehtë si i tillë, falë pranisë së tij në origjinal në fondet e Arkivit Historik të Propaganda Fide-s në Romë.<sup>10</sup>

Le të shtojmë këtu edhe një detaj të fundit, por më se të rëndësishëm si për historikun e tekstit ashtu edhe për analizën e tij filologjike. Është fjala për një variant të dytë të tekstit shqip [= var. B2], shkruar nga një dorë e dytë në faqen e parme të një flete të veçantë, e palosur dikur gjashtësh, por e dëmtuar shumë në fund, e cila i është bashkëlidhur regjistrit me kapëse metalike në fol. nr. 8, ku është shkruar var. B1.

## 1.2 Përmbajtja dhe organizimi i tekstit

Vetë titujt e tekstit në variantin italisht: <I Scommunicati nel Giovedi Santo> (= Të shkishëruarit të Enjten e Shenjtë) dhe atë shqip: <Małekimet chi lescion Vpesckepi Teinten Emaçe> (var. B1), edhe pse nuk përkojnë plotësisht me njëri-tjetrin, na qartësojnë deri diku lidhur me përmbajtjen e tij. Bëhet fjalë për të shkishëruarit përkatësisht mallkimet që i lejohej dhe duhej të bënte ipeshkvi gjatë kremës së Pashkëve, bash të Enjten e Madhe, një ditë para të Premtes së Zezë, që përkujton Kryqëzimin e Krishtit. Këtë të drejtë e gëzonte atëbotë vetëm

<sup>8</sup> Bëhet fjalë këtu për relacionin e gjatë të vizitës së tij apostolike që i parapriu mbajtjes së Koncilit Provincial ose Kuvendit (të Parë) të Arbënit në Mërqinjë më janar 1703. Dokumenti origjinal i depozituar në Arkivin Historik të Propaganda Fide-s (APF SC (Albania) fol. 535vv.) është botuar i plotë prej Peter Bartl-it: Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert, Bd. II, München 1979, f. 3-187.

<sup>9</sup> Ipeshkëvi i Shkodrës gjatë viteve 1702 – 1718 dhe pjesëmarrës në Kuvendin e Arbënit (1703). Shih më hollësisht Farlati, D. & Coleti, J.: Illyricum Sacrum, t. VII, Venedig 1817, f. 332vv.

<sup>10</sup> E tillë është p.sh. edhe kopja e një letre referencë e arqipeshkvit të Shkupit, Imz. Gjon P. Nikollë Kazazit (20 dhjetor 1746) dërguar Kongregatës së Shenjtë (SC Servia I, fol. 390) për pranimin e nipit të zëvendëskonsullit të Republikës së Venedikut në Shkodër në njërin ndër kolegjet ilirike në Itali. Shih Nevila Nika *vep. cit.* 229. Për variantin origjinal shih Bardhyl Demiraj: Jeta dhe trashëgimia e Gjon. P. Nikollë Kazazit, Shkodër 2013 307vv.

ipeshkvi dhe vetëm atë ditë për të dënuar sipas rastit besimtarë ose klerikë që kishin kryer abuzime dhe shkelje të jashtëligjshme, përkatësisht për syresh që binin në kundërshtim të hapur me të drejtën kanonike kristiane dhe me nomet e Kishës Katolike-Romake.

Siç do ta shohim më poshtë (§§ 2.1.1/2 dhe 3), i gjithë teksti numëron si raste ekstreme vjedhjet e plaçkitjet e shtëpive dhe kishave, shitjen e pasurisë të tundshme të kishës, dhunën ndaj klerit dhe rishtarëve në shkollat katolike, martesat e përziera, rrëmbimet e femrave, mbajtjen në shtëpi të grave shemra (konkubina), skllavërinë, martesat me provë, magjitë dhe dështimet e vetëdijshme të barrës, prishjen e lidhjes martesore në kishë dhe rimartesën, mosbindjen ndaj vendimeve që merr ipeshkvi, përkatësisht kallëzimin e tij në organet gjyqësore të pushtetit lokal etj.<sup>11</sup> Teksti përmbillet në fund me një urdhëresë që u drejtohet klerikëve me mos mbajtur kurrsesi meshë natën e Kërshëndellave, madje as të mos rrëfejnë natën e pa zbardhur mirë dita.

Një përjasje sado e përciptë e var. A me var. B1 lejon të saktësojmë që në fillim se nuk kemi të bëjmë në çdo rast me ndonjë përkthim të fjalëpërfjalshëm (*ad verbum*) të njërit variant ndaj tjetrit, se sa më fort me kompilime paralele italisht dhe shqip të atyre rasteve ekstreme që parashikohen të fshikullohen prej ipeshkvit me shkishërim. Këtë rrethanë e vërejmë jo vetëm në përjasjen e titujve, por edhe në mënyrën e paraqitjes së shkeljeve, të cilat në var. B1 formulohen rregullisht me fjali të plota shqip, ndërkohë që në var. A në shumicë rreshtohen thukët në italisht, përkatësisht duke cituar vetëm emërtimet përkatëse. Dallime kemi gjithashtu edhe në numërimin e rasteve të shkeljeve, meqë var. A me 21 syresh në numër i vihen përballë 19 (+ 1 e panumëruar) në var. B1.

Ballafaqimi i var. B1 me B2 fiton më fort interes sidomos për analizën filologjike të tekstit (§ 2.1.2). Gjithsesi, edhe pse nuk njohim asnjë hollësi lidhur me rrethanat e përfutimit të var. B2,<sup>12</sup> nuk hasim aspak vështirësi për të përsiatur bindshëm që ky variant është një kopjim deri diku i kujdesshëm i var. B1, duke mënjanuar për çdo rast edhe ato prishje apo ndreqje që janë ndërmarrë në var. B1.

### 1.3 Kronologjia dhe autorësia e tekstit

A kemi të bëjmë me var. A dhe B1 në regjistrin në fjalë me kopjime dokumentesh të mëhershme origjinale sot për sot të panjohura? Këtë pyetje e hedhim si të tillë për herë të parë në debat, duke dashur të

<sup>11</sup> Një përpjekje të parë për sistematizimin e këtyre abuzimeve e ndeshim të Nevila Nika *vep. cit.* 39v.

<sup>12</sup> Rrethanat e përfutimit të këtij varianti mbeten të errëta, pasi nuk ndeshim kurrfarë shënimesh arkivore në dosjen në fjalë. Ndër studiuesit që janë marrë deri sot me hetimin e variantit shqip është vetëm Nevila Nika (*vep. cit.* f. 39) që përmend ekzistencën e dy varianteve në gjuhën shqipe (shih më poshtë § 2).

shtrojmë për diskutim kronologjinë e tekstit burimor së bashku edhe autorësinë e tij. Sigurisht që edhe në këtë rast nuk duam të vëmë aspak në dyshim, përkundrazi i mëshojmë edhe më fort rrethanës që hedhja e tyre në regjistër i takon bash periudhës së viteve 1744/45.<sup>13</sup> Të nxitur nga kjo rrethanë, studiuesit pranojnë sot përgjithësisht si të mirëqenë një bashkëlidhje të ndërvarur (= kauzale) midis shkrimit të varianteve në regjistër, përmbajtjes së tekstit shqip me ato drejta që gëzonte ipeshkvi si edhe faktit që atëbotë Ipeshkvia e Shkodrës kishte bari të vet, Imz. Pal Pema Kampsin (= <Paolo Pema Campsi>), të cilit – për rrjedhojë – nuk mungojnë t'i veshin edhe autorësinë e vetë tekstit.<sup>14</sup>

Njohja nga afër me materialin burimor që ofron ky regjistër si edhe me vendin e tekstit tonë në të na lejon gjithsesi të përsiasim paraprakisht si zgjidhje qoftë edhe alternative praninë e një teksti burimor të mëhershëm, i cili mund dhe duhet të jetë kopjuar në regjistër bash në vitin 1744, sikurse edhe tekstet e tjera që e rrethojnë, siç është p.sh. rasti me ato pjesë nga relacioni i vizitës apostolike të Imz. Vinçenc Zmajeviqit (1702)<sup>15</sup> që i paraprijnë, përkatësisht me dokumentin pasues që përcjell vendimet e sinodit dioqezan të Beltojës (13 mars 1704), të hartuara mirë e bukur nga Imz. Ndue Babi (= <Mons. Antonio Babbi>). Shkeljet e rënda ndaj nomeve të fesë katolike-romake së bashku me raste të tjera abuzive që shqyrtohen në atë sinod, ku saktësohet njëherazi edhe roli vendimmarrës vetëm i ipeshkvit në dënimin e mëkatarëve, përkatësisht çlirimin e tyre ndaj mëkateve (nëpërmjet dhurimit të Sakramentit të Pendesës),<sup>16</sup> vërejmë se përputhen plotësisht me “Mallkimet e Ipeshkvit të Enjten e Madhe” para Pashkëve në të dyja variantet e tekstit tonë. Këto rrethana e tumirin bindshëm zgjidhjen alternative që i ofrojmë tash debatit intelektual-albanologjik, duke mëtuar kështu me të drejtë që teksti ynë duhet të jetë hedhur në letër së pari aty rreth viteve 1703-1704, duke pasur si i tillë për autor Imz. Ndue Babin dora vetë.<sup>17</sup>

13 Në këtë përfundim vjen edhe Nevila Nika (2001 39), pasi ka marrë në analizë edhe bojën e përdorur në dokument.

14 Khs. K. Kampsin, Gj. Sheldinë, Dh. Shuteriqin e T. Osmanin në vendet e cituara (fush. 1-5) që kanë fiksuar përfundimisht vitin 1744 si kohë e hartimit të tekstit dhe me autor Imz. Pal Pema Kam(p)sin, ndërkohë që Nevila Nika (*vep. cit.* 132v.) kumton vitin 1704 pa bërë interpretimin e nevojshëm dhe pa përsiatur autorësinë e tij.

15 Sipas Peter Bartl-it (*vep. cit.* IX) ky relacion është hartuar në gjysmën e dytë të vitit 1703.

16 Vendimet e këtij sinodi nuk mund të vështrohen jashtë masave paraprake që u ndërmorën një vit më parë në Kuvendin e Arbënit (Mërqinjë, janar 1703). Shih më hollësisht në Bardhyl Demiraj: *Koncili Provinciali o Kuvendi i Arbënit (Romae 1706)*, Shkodër 2012, f. 9vv.

17 Lidhur me këtë çështje, interes të veçantë në aktet sinodale fiton sidomos hetimi i kreut “Della Confessione” (= shq. “Mbi rrëfimin” – f. 20-23), ku Imz. Ndue Babi saktëson të drejtat e famullitarëve lidhur me dhënien e Sakramentit të Pendesës pas rrëfimit të mëkateve të falshme (= veniale), ndërkohë që atyre nuk u lejohet aspak falja e mëkateve mortore (= të rënda), për të cilat do kërkuar leje vetëm prej tij. Kështu, sipas tij: <Li casi riservati á noi sono



Nuk mund të mos shtojmë me këtë rast si argument shtesë në të mirë të kësaj teze edhe burimet më se të sigurta arkivore, të cilat i mësojmë tash falë punës ngulmuese të filologut Gëzim Gurga me botimin kritik të fjalorit në dorëshkrim të Francesco Maria da Lecce-s, ku citon edhe “dorëshkrime të tjera, si fjala vjen, veprat e Arqipeshkvit të Shkodrës Anton Babit, që iu paraqitën për botim Kongregatës e që nuk u botuan kurrë.”<sup>18</sup>

## 2. Teksti dhe sistemi grafik e varianteve shqip

Përshkrimi i sfondit historik e social-kulturor, në të cilin dhe për të cilin ishte destinuar teksti si edhe shestimi i përsiatjeve të reja, që kanë të bëjnë me datimin dhe autorësinë e tij, mbulojnë vetëm një pjesë të qëllimit të studimit tonë. Ribotimi filologjik i tekstit, të cilit do t'i përkushtohemi në këtë rubrikë, përbën hallkën kryesore të këtij qëllimi. Përmbushja e tij parakupton, ndër të tjera, parashtrimin dhe zgjidhjen e disa çështjeve që kanë të bëjnë me zberthimin e kodit alfabetik dhe njohjen e rregullave grafike e ortografike, të zbatuara në tekst. Paraqitja paraprake dhe rezultative e hulumtimit të këtyre çështjeve shpresojmë që të lehtësojë leximin dhe njohjen e tij. Kështu, më poshtë lexuesi mund të përcjellë fillimisht riprodhimin diplomatik të var. A e menjëherë pas

---

*l'infrastritti, dalli quali non possono gli Parochi assolvere li penitenti senza la nostra espressa licenza: 1. Li percussori de' chierici, Parenti, e quelli [che – B.D.] danno ajuto, consiglio, e favore, e gl'Apostati; 2. Gli Simoniaci, et ancora li loro fauoreuoli; 3. Chi commette homicidio uolontario, et anco l'aborto uolontario.; 4. Gli maleficiatori, et incantatori.; 5. Gli Rattori delle Donne.; 6. Gl'Incendiarij.; 7. Chi rompe gli Testam[en]ti; 8. La Sodomia etiam con le femine, e Bestialità.; 9. La consanguinità fino al 3.º grado, e la copula carnale con la Cognata Spirituale.; 10. L'usurpare li beni delle Chiese.>, duke vazhduar më tej: <Unavolta l'anno, cioè nella Pasqua di Resurrezione concediamo facultà alli Parochi d'assolvere li Penitenti dalli maleficij, et incanti, dagl' Incendij, dalla Sodomia, e Bestialità, dalla Consanguinità, e Copula carnale con la Cognata Spirituale.> (f. 22). Llojet dhe radhitja e mëkatëve mortore, përkatësisht procedura ndaj mëkatarëve përkatës gjatë kremës së Pashkëve bashkëlidhen lirshëm në brendi dhe formë me tekstin (sidomos me var. A), rrethana këto që e tumirin bindshëm tezën tonë mbi kronologjinë e përafërt dhe autorësinë e tekstit.*

**18** Shih Gëzim Gurga. (bot.) *At Francesco Maria da Lecce Dittionario: Dittionario Italiano - Albanese (1702)*, Shkodër 2009, f. 35. Kolegu dhe miku im Gëzim Gurga pati gjithashtu mirësinë të më verë kohët e fundit në dispozicion edhe kopjen (1717) e një teksti protokollar origjinal të Komisionit vendimmarrës në instancën e lartë të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s (*Acta Sacrae Congregationis 1717* vol. 87 ff. 279v, [mbledhja e dt.] 23 Augusti 1717), ku thuhet shprehimisht që Ndue Babi kishte bërë të njëjtën kërkesë në vitin 1715, por që Kardinal Barberini, i ngarkuar nga ky komision me dhënë gjykimin përfundimtar, nuk dha pëlqimin për botim: “Mons. Babbì Vescovo di Scuttari con memoriale presentato dal suo Agente, torna di nuovo a supplicare l'EE. V.V. / Primo, di un luogo in qualche collegio [...] / secondo Della Stampa della Dottrina Christiana, e letanie della Beata Vergine, da esso tradotte dal Latino in Lingua Albanese per beneficio di quei Popoli. / Di che il medesimo oratore (Or<sup>o</sup>e.) ha altre volte fatto istanza nel 1715, e fù rimessa all'Emmo Barberini ma per quanto asserisce lo stampatore l'opera non fù stimata a proposito per esser stampata. [...] Ad 2<sup>us</sup> = Arbitrio Emmi Barberini”.

tij paralelisht në dy kollona: var. B1 (majtas) dhe B2 (djathtas), të cilat pasohen nga komentaret përkatës për çështje të ndryshme të karakterit grafik, gjuhësor dhe semantik. Gjithsesi për çdo gjetje dhe interpretim lexuesi mund të marrë pjesë aktive në diskutim, duke bërë përqasjet e rastit me edicionin e tij kritik së bashku me variantin italisht dhe me faksimilet që shoqërojnë si shtojcë këtë studim.

## 2.1 Riprodhimet diplomatike të tekstit italisht dhe shqip

### 2.1.1 Riprodhimi diplomatik i tekstit italisht (var. A)

	[f. 11]
	I Scommunicati nel Giovedi Santo
1	Gli Incendiarij.
2	I percussori dei Chierici.
3	Chi occupa gli beni Ecclesiatici.
4	Chi marita le figlie, sorelle, nipoti, serve, ó altre femine con gli Infedeli.
5	I Rattori delle zitelle, vedove, o altre femine et i loro fantori
6	Quello, che nello stesso tempo tiene due Donne.
7	Chi pigliasse, ó tenesse la cognata, zia &c.
8	Chi non contrae il Matrimonio in facie Ecclesiae subito presa la Sposa.
9	Chi vende i Christiani, e le Christiane per schiave &c.
10	Chi rompe il Testamento &c.
11	Chi cita al Tribunale secolare gli Ecclesiatici.
12	Quei Sacerdoti, che col braccio di Secolari, ó Turchi s'introducono nelle Parrocchie, e quelli che con le sue forze, e degl' altri impediscono il Prelato volendo trattener, ó scacciar i Sacerdoti luogati da lui.
13	Quelli, et quelle, che fanno fattucherie per impedire la copula matrimoniale, ó per non haver prole, ó per separar i congiunti &c: come pure quelli, et quelle, che vanno ad indovinare.
14	Quelle Donne, ó zitelle &c: procurano l'aborto, e chi le favorisse, consigliasse, &c ajudasse &c.
	[f. 12]
15	Quelli, che havendo fidata la figlia, sorella, ó nepote &c. per uno, morto questo la danno al Fratello di questo, ó pure morta quella, á cui è stata fidata li si da la sorella.
16	Quelli, che abbandonano la moglie legitima, e ne pigliano un' altra illegitimamente &c.
17	I bagerdi, e le mangerie nelle feste delle proprie Chiese.
18	I Simoniaci &c.
19	Chi rompesse per dispetto la casa altrui, ó abbrugiasse i fieni.
20	Chi facesse sorelle giurate. Amen
21	Niun Paroco celebrar la messa di natale avanti spuntato il sole, ó il giorno.

## 2.1.2 Riprodhimi diplomatik i tekstit shqip<sup>19</sup>

↓	Varianti B1	Varianti B2
	f. 12 Małekimët , chi lëscion Vpësckepì Teinten Emaže	Mał\ë/kimët , chi lëscion Upesckepì T'Ei\n/ten E maže
1	Kiofscin małekuëm atà , chi dieghen sctepiin , e chieter ngiaa te huein , endè atà , chi te ξξein per inaat sctepiin e huei .	Kiofscin małekuëm , chi dieghen sctepiin , e chieter \n/giaa te huein , endè atà , chi te ξξein per inaat sctepiin e huei .
2	Kiofscin małekuëm atà , chi te rraffin Giacoit hiim nder urξenime .	Kiofscin małekuëm atà , ci te rraffin Giacoit hiim nder urξnime[ t] .
3	Kioft małekuëm kusc te εaptoin ngiaan e kiscëss .	Kioft małekue kusc te εaptoin ngiaan e Kiscëss .
4	Kioft małekuëm kusc te martoin Biat , motrat , mbëssat , fcerbetoret , ó chiera Graa jasct Feje soon .	Kioft małekuëm kusc te martoin biat , motrat , mbëssat , fcerbtoret , e [ kc] chiera graa jasct Feje soon .
5	Kioft małekuëm kusc té grabífsén vaareat , tevejat , ó chiera Graa , endè kusc te mbahet sebét , e ndim .	Kioft małekuëm kusc te grabífsen vaareat , te vejat , ó chiera graa , endè kusc te bahet sebét , e ndim .
6	Kioft małekuëm ài , chi te mbaan dyy graa .	Kioft małekuëm ai , [ ] te mbaan dyy graa .
7	Kioft małekuëm ài , chi te marren per Grue te kunaten ó Tempten , ó chieter Grue , chi eieep Ligia jon .	Kioft małekuëm ai , chi te marren per grue te kunaten o tempten , ó chieter grue , chi sieep Ligia .
8	Kioft małekuëm ài , chi nsvè kunor me Príft te fambuliiss mbatè nat chi martohet .	Kioft małekuëm ai , chi nsvè kunor me Príft te fambuliiss mbatè nat chi martohet .
9	Kioft małekuëm ài , chi scet te kersctenet , e tekersctenat per Robigna .	Kioft mał\ë/kuëm ài , ci scet te kersctenet , e te kersctenat per robigna .
10	Kioft małekuëm ài , chi ξξen Testamendët , e [ ]iarten fialen etyne .	Kioft małekuëm ai , ci ξξen Testamendët , e ciarten fialen e tyne .
11	Kioft małekuëm ai , chi te ciognèn mγγεγγr Príftene .	Kioft małekuëm ai , ci te ciognen mγγεγγr [ ] Príftene .
12	Kiofscin małekuëm atà Príften , chi mçrahe te secułarevet , ó Turchiet hiignèn me εaptue Fambulijt , endè atà , chi me forz te tγne , ò te chietercui duén me mbait , ó me pεεan atà Príften , chi te keet vendue vpësckepì .	Kiofscin małekuëm atà Príften , ci mçrahe te sec[ ]łarevet , ó Turchiet hiignen me εaptue fambuliit , endè atà , chi me forz te tγn[ ] , ó te chietercui duen me mbait , ó me pεεan atà Príften , chi te keet vendue Upesckepì .
13	Kiofscin małekuëm ató Graa , ó vaarea , chi chiefsen barren posct , endè atà , chi kesciiłofscin , e ndimofscin me ketè pun .	Kiofscin małekuëm ato graa , ó vaarea , ci chiefsen barren posct , endè ata , chi kesciiłofscin , ó ndimofscin me kete pun .
14	Kiofscin małekuëm atà , e atò , chi bain mengii , e li[ ]n Nierëit me kunor , ó per me moss baam femij , ò per me i daam , endè atà perserij , e atò chi chiefsen sciort .	Kiofscin małekuëm ata , e ato , ci bain mengii , e liξin nierëit me kunor , ó per me moss baam femii , ó per me i daam , ende atà perserii , e ato ci chiefsen sciort .

<sup>19</sup> Ndër shenjat konvencionale që kemi përdorur në riprodhimin diplomatik të faksimileve dallojmë: \n/ – shkronjë/pjesë teksti e shtuar në rresht ose mes rreshtash nga lart; [—n] – shkronjë/pjesë teksti e prishur por e lexueshme; [ ] – shkronjë/pjesë teksti e prishur/fshirë dhe e pallexueshme.

15	Kiofscin maalekuem atá , chi tue pafsun fejuem te Bijñ , te motren , ó te mbefsen per gnà , decun ky e apen perserij tevelaat ketij , ó decun vaiëa e fejueme per ntá , ti jaepen perserii té moteren .	Kiofscin maalekuem ata , ci tue pafsun fejuem te biin , te motren , o te mbefsen per gnà , dekun ky e apen perserii te velaat ketii , o dekun vaiëa e fejueme per ntá , ti ja epen perserii te motren . Kiofscin maalekuem ata ci dain e marren chiera graa me kunor .
16	Kiofscin maalekuem atà , chi dain Graat mé kunor , \e marren ch[ ]era/	- Kioft maalekuem ai , chi te mbaan
16*	Kioft malékuém ai , chi te mbaan \ò te rrisen/ dial e vaië te fejueme [ E marren] nde sctepij basck . f. 14 [ marrén chiera] [ Kioft maalekuem kusc voft ne fest me gran , le me pijm .] [ Kioft mall. kusc ξξeft p inaat sctepijn é huéi , e dieght casctat e huéj]	ó te rrisen dial e vaië te fejueme ne sctepii basck .
18	Kioft maalekuem kusc fcét ngiaan e kiscéfs. [ Astukioft]	17 Kioft maalekue kusc fcet ngiaan e Kiscéfs.
19	\Kioft malékuém/ kusc baft motra mbe Tenéëon . Asctu kioft.  Ricordo Kerscende lasc curr gni Prift mos te ξξeet mésc natén , paa sbarξ drita mir , e mos té rréfyëin naten , as mbassi te perandoin dieali.	18 Kioft maalekue kusc [ fo] baft motra mbe Tenëon . Asctu kioft .  [ ]

### 2.1.3 Paskohësi e var. B2 ndaj var. B1

Një përqsasje sado e përçiptë midis dy varianteve shqip të tekstit nxjerr shpejt në pah një tufëz shmangiesh grafike të var. B2 prej var. B1 që mund të interpretohen sipas rastit a) me një kopjim të pakujdesshëm, ose më fort b) me shmangie nën ndikimin e ligjërimit të thjeshtë nga ato rregulla normative që mund dhe duhet të kenë ekzistuar aso kohe në formë sado rudimentare në shqipen e shkruar në arealin kulturor të Veriut.<sup>20</sup> Gjithsesi këto shmangie kumtojnë për çdo rast paskohësi të hedhjes në letër të var. B2 ndaj var. B1 në regjistër.<sup>21</sup> Prashtu, vetëm duke marrë parasysh këto rrethana mund të interpretojmë, ndër të tjera:

- Korrigjimet e vetëdijshme drejtshkrimore, khs.: (titull: var. B1) <Maalekimet>, <Teinten> ~ (B2) <Maal\ e/kimet>; <T'Ei\ n/ten>; (1 B1) <ngiaa> ~ (B2) <\ n/giaa> etj.<sup>22</sup>
- Format e shpeshta (popullore), të ashtuquajtura “jonormative”,

<sup>20</sup> Shih Bardhyl Demiraj: Norma gjuhësore dhe substandardi në një tekst shqip të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut, në: „Hylli i Dritës“ 1 [2011] 79vv.

<sup>21</sup> Shih edhe më lart § 1.2.

<sup>22</sup> Në këtë rubrikë mund të ndërkallim edhe variantet e tipit (7 B1) <chi eieep> ~ (B2) <chi sieep>.

khs.: (2 B1) <chi>, <urξenime> ~ (B2) <ci>, <urξnime>; (3 B1) <maλekuem> ~ (B2) <maλekue>;<sup>23</sup> (4 B1) <{cerbetoret}> ~ (B2) <{cerbtoret}> etj.

- Harresat, khs.: (1 B1) <Kiofscin maλekuem atá, chi> ~ (B2) <Kiofscin maλekuem, chi>; (7 B1) <chi sieep Ligia jon.> ~ (B2) <chi sieep Ligia.> etj.
- Prishjet me shkarravitje të disa pikave në var. B1 (khs. 16\*), përkatësisht mënjanimi i tyre në rinumërim gjatë hedhjes në letër të var. B2 (khs. B1 nr. 18, 19 kundrejt B2 nr 17, 18).

## 2.2 Tipare të grafisë së tekstit shqip

Një vështrim sado i përciptë i dy varianteve të tekstit shqip nga perspektiva filologjike të krijon menjëherë përshtypjen se në të është i pranishëm i ashtuquajtura "Alfabet i Propagandës" apo "Alfabet i Shkodranishtes së Vjetër",<sup>24</sup> më se i njohur në botimet shqip në (ose me destinacion) arealin e Shqipërisë së Veriut.<sup>25</sup> Për këtë po mjaftohemi të kumtojmë përmbledhtas, që:

- a) Alfabeti i përdorur në këto shkrime me gjithë-gjithë 26 shkronja bazohet fund e krye në atë të latinishtes (mesjetare dhe të italishtes) me 22 syresh, khs.: <a b c d e f g h i j k l m n o p r l/s t u v z>. Sikurse thuhet në të gjitha botimet shqip të arealit kulturor-fetar të Veriut pas Bogdanit (1685) përdoren në tekst karaktere grafike po aq tradicionale, por me tjetër burim: <γ ξ ε λ>.
- b) Mjetet grafike të përdorura në kod përkrijnë plotësisht me ato të arealit kulturor të Veriut, i cili bazohet kryekëput në rregullat (orto) grafike të shkrimit të italishtes. Dallojmë këtu, ndër të tjera:
  - përdorimin e shkronjave <i> dhe <h> edhe si mjete grafike (shih poshtë tabelën).
  - përdorimin e theksit në zanoret fundore, khs.: <atá>, <endè>, <atà>, <ó>, <té>, <nsvé> etj.
  - dyfishimin e bashkëtingëlloreve kryesisht sipas rregullave ortografike të leximit të fonemës /s/, khs. <te mbessat>, <te rrisen>, përndryshe krejt sporadik (për të shënuar edhe gjatësinë përkatësisht intensitetin), khs.: <te rraffin>, <moss>.
  - Po ashtu edhe pikësimi është – sikurse pritet – i ndikuar kryekëput nga rregullat e drejtshkrimit të italishtes.
- c) Llojet e grafemave në tekst përkrijnë me ato të shkrimit shqip në

<sup>23</sup> E ashtuquajtura pjesore e shkurtuar (pa {-m}) del vetëm në dy raste në var. B1, khs.: (12) <chi te keet vendue>, <me eaptue>.

<sup>24</sup> Khs. Át Justin Rrota: Për historinë e alfabetit shqyp, Shkodër 1935 69vv.

<sup>25</sup> Për një traditë të ngjashme të shkrimit shqip në zonën e Himarës shih së fundi B. Demiraj: Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII, në: "Studime" 12 [2005] 67-97.

arealin kulturor fetar të Veriut. Ndër to dallojmë:

- Grafema të thjeshta njëvlerëshe, khs.: <λ ε f t> = /ll z f t/.
- Grafema të përbëra (digrame) njëvlerëshe, khs.: <ξξ aa gn chi> = /th ā nj q/.
- Grafema të thjeshta shumëvlerëshe (= me distribucion në varg), khs.: <c-A ~ c-E> = /k/ ~ /ç/.
- Germat majuskula: jo vetëm në fillim fjalie dhe për emra të përveçëm, por edhe për të dalluar grafikisht institucione dhe/ose nocione themelore teologjike apo administrative e të ngjashme me to, khs.: <Teneεon>, <Kisces>, <Giacoit>, <Turchiet>, <Graa>, <Biat> etj.

### 2.2.1 Kodi alfabetik i dy varianteve të tekstit shqip

Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelare kodin alfabetik të zbatuar në tekst.

#### a. Grafemat e tingujve zanorë:

IPA	Kodi alf. Mallkim.	Alfabeti Manast.	Shembuj nga dy variantet e tekstit	Gjegjësit e transkriptuar
[a]	<a>	<a>	atá, Biat, Emaçe, bain	ata, biat, e Madhe, bain
[a:]	<aa>		ngiaa, inaat, graa, vaarea	ngjā, ināt, grā, varzat
[e]	<e>	<e>	Teinten, endè, e huei, Feje	t' Einten, ende, e huei, Feje
[e:]	<ee>		te keet, te ξξeet, sieep	të kēt, të thēt, s' jēp
[ə]	<e>	<ē>	(per, té, nde, barren, ketè)	(për, të, ndë, barrën, këte)
[o]	<o>	<o>	kioft, motra, ò, kunor, atò	kioft, motra, o, kunor, ato
[o:]	<oo>		soon	sōn
[i]	<i>	<i>	kiscess, ndim, Ligia, ài, i	kishës, ndim, Ligia, ài, i
[i:/ij]	<ii/ij>		hiim, Fambuλijt, mengii	hīm, Fambullit, mëngji
[y]	<y>	<y>	te tyne, te rrefyein, ky, ky	të tyne, të rrëfyein, ky, ky
[y:]	<yy>		myyεyyr, dyy	mýzýr, dý
[u]	<u/v>	<u>	kusc, Grue, te kunaten	kush, grue, të kunaten
[u:]	<uu>		(nuk dëshmohet)	(nuk dëshmohet)

#### Vërejtje:

1. Vërejmë fillimisht që në të dyja variantet në dorëshkrim shkronja/grafia <e> rezulton gjithkund në tekst – pra *de facto!* – vetëm me një vlerë grafemore, përkatësisht gëzon vlerën kuptimdalluese të një grafeme të vetme, e cila mund dhe duhet të mbulojë sipas rastit realizimin fonetik të dy fonemave (të sotme) zanore: a) të zanores së përparme të ngritjes së mesme [e], dhe b) të së ashtuquajturës “e-ja e pazanë” si një zanore e reduktuar [ə] (*Schwa*), që shfaqet qoftë në rrokje të patheksuar, ashtu edhe në fjalë shërbyese kryesisht njërrrokëshe me theks dytësor, përkatësisht jashtë theksit. Dallimi i tyre grafik në variantin kritik të tekstit (shih § 3) është gjithsesi

një ndërhyrje thujse *ad hoc* nga ana jonë, që motivohet kryesisht me rezultatet e hulumtimit gjuhësor diakronik, por edhe me risitë në kodin alfabetik të kryer nga Bogdani (1685),<sup>26</sup> të cilat gjetën përkrahje risuese edhe nga ndonjë autor tjetër gegë në shek. XVIII (Kazazi 1743), si edhe me ndjenjën e sotme gjuhësore të studiuesit filolog, përkatësisht të lexuesit potencial shqipfolës.

2. Në tekst arrijmë të izolojmë në pikëpamje grafike edhe zanoret e gjata, të cilat – siç pritet – në çdo tekst të arealit kulturor të Veriut paraqiten kryesisht me dyzim të shkronjave zanore: <aa>, <ee>, <oo>, <yy>, <ii> (krahas <ij>).
  - Shkurtësia e tekstit nuk jep shkas për të diskutuar praninë apo mospraninë e zanores së gjatë <uu> = /ū/ në gjuhën e hartuesit, përkatësisht të kopjuesit të dy varianteve.
  - Në tekst nuk ndeshim gjithashtu kurrfarë gjurmësh që përcjellin grafikisht sistemin e zanoreve hundore të dialektit gegë. Ndonjë rast sporadik, si p.sh. korrigjimi i kryer në titullin e variantit 2 të tekstit: <t’ Ei \n/ten> lejon përsiatje paksa të guximshme, të cilat nuk i shkojnë aspak përshtat studimit tonë.

## b. Grafemat e tingujve bashkëtingëllorë:

IPA	Kodi alf. Mallkim.	Alfabeti Manast.	Shembuj nga teksti	Gjegjësit e transkriptuar
[p]	<p>	<p>	Vpesckepi, per, Prift, posct	upeshkëpi, për, prift, posht
[b]	<b>	<b>	sebét, Bijn, barren, bain	sebet, bîn, barrën, bain
[t]	<t>	<t>	Kioft, te martoin, Tempten	kioft, të martoin, t’emptën
[d]	<d>	<d>	endè, nder, ndim, duén, dyy	ende, ndër, ndim, duen, dÿ
[k]	<k>	<k>	dekun, kunor, te keet, basck	dekun, kunor, të kët, basck
	<c>	<c>	Giacoit, chietercui, decun	gjakoit, qeterkui, dekun
[g]	<g>	<g>	grabifsen, grue, me gran	grabisën, grue, me gran
	<gh>	<gh>	dieghen, [— dieght]	diegën, [— diegt]
[ç]	<chi>	<q>	chi chiera chieter Turchiet	qi, qera, qetër, turqet
[j]	<gi>	<gj>	ngiaan, Ligia, mengii	ngjān, ligja, mengji
[f]	<f>	<f>	te rraffin, Feje, Prift, fialen	te rrafin, feje, prift, fialën
[v]	<v>	<v>	tevejat, nsvè, vaiεa	te vejat, ns’ vè, vaiza
[θ]	<ξξ>	<th>	te ξξein, te ξξeet	të thein, të thët
[ð]	<ξ>	<dh>	Emaξε, urçenime, sbarξ	e Madhe, urdhënime, sbardh
[s]	<s/f>	<s>	mos, as, chiefsen, mbassi	mos, as, qesën, mbasi
[z]	<ε>	<z>	te εaptoin, me perεan, vaiε	te zaptoin, me perzan, vaiz

26 Në var. B1 ndeshim herë pas here raste identifikimi të zanores /ə/ “të pazanë” me theks – të mprehtë ose të rëndë – si mjet grafik (përvoja e Bogdanit), khs.: <kusc të grabifsen>, <chi te ciognèn>, <hignèn>, <e kiscéfs>, <Tenèεon>, <mos të rrëfyein naten>. Gjithsesi nuk mund të mëtojmë se këto janë gjithnjë domethënëse, përkatësisht ndërhyrje të ndërgjegjshme grafike të shkruarit, meqë kolidojnë rregullisht me raste po aq sporadike të zanores së mesme, të përparme nën theks, sidomos në pozicion fundor, khs.: <endè>, <mè kunor>. Këtu ndërkallen edhe raste interpretimi dyfish, të tilla si: <mbatè nat>, <me ketè pun>, <të moteren> etj. Krejt sporadike janë rastet e grafisë <ε> nën theks (= <è> ~ <é>) te var. B2, në të cilat gjykojmë përgjithësisht një zanore të përparme të hapur: [ε] = /e/.



[ʃ]	<l/sc(i)>	<sh>	lescion, kusc, scet, posct	lëshon, kush, shet, posht
[ʒ]	----	<zh>	---	---
[ts]	<z>	<c>	forz	forc
[dz]		<x>	---	---
[tʃ]	<c(i)>	<ç>	ci (V 2), ciognen, ciarten	(çi), çonjën, çartën
[dʒ]	<g(i)>	<xh>	(?)	(?)
[h]	<h>	<h>	te huein, hiim, te mbahet	te huein, hīm, te mbahet
[j/ʃ]	<j/i>	<j>	jasct, jon, fejuem, Kiofscin	jasht, jon, fejuem, Kiofshin
[m]	<m>	<m>	me, ndim, femij, [—me pijm]	me, ndim, fēmī, [—me pīm]
[n]	<n>	<n>	nat, soon, nde, te kersctenet	nat, sōn, ndë, të kërshetenët
[ɲ]	<gn>	<nj>	Robigna, hiignen, gnà, gni	robinja, hīnjën, nja, nji
[l]	<l>	<l>	dial, Ligia, fialen, lixin	dial, ligja, fialën, lidhin
[ʎ]	<λ>	<ll>	malëkuem, tevełaat, diełi	mallëkuem, të vellāt, dielli
[r]	<r>	<r>	Robigna, nder, fcerbetoret	robinja, ndër, shërbëtorët
[r]	<rr>	<rr>	barren, te rrefyein, curr	barrën, të rrëfyein, kurr

### Vërejtje:

- Shkurtësia e tekstit nuk lejon identifikimin e gjithë fondit të tingujve bashkë-tingëllorë me vlerë kuptim dalluese (= të fonemave), si psh. /zh/, /xh/, /x/.
- Autori dallon qartë grafikisht dikotominë e likuideve në shqipe:
  - <l> ~ <λ> = /l/ ~ /ll/, khs. <lescion>, <Ligia>, <fialen>, <lixin>, <dial> ~ <malëkuem>, <fambułiiss>, <secula l revet>, <kesciiłofscin>, <vełaat>, <Kerscendełasc>, <diełi>;
  - <r> ~ <rr> = /r/ ~ /rr/, khs.: <chieter>, <nder>, <per>, <urxenime>, <motrat>, <kunor>, <Prift>, <Robigna> ~ <raffin>, <marren>, <barren>, <curr>, <mos te rrëfyein>.
- Stabilizim shënon gjithashtu paraqitja grafike e fonemës /sh/ që i shkon përshtat rregullave grafike të italishtes:
 

<sc-C>: <upesckepi>, <scetepiin>, <jasct>, <kersctenet>, <posct>, <bask>, <sc#>: <kusc>, <Kerscendełasc>, <mésc>, <sci-A>: <lescion>, <sciort>, <sc-i/e>: <Kiofscin>, <kiscess>, <scet> <kesciiłofscin>, <kiscèfs>, <Kerscendełasc>.
- I njëjti regjim shfaqet edhe në paraqitjen grafike të fonemave /g/ ~ /gj/:
 

/g/ = <gh-E>: <dieghen> pranë <dieght> (ku ruhet përbërja grafike e morfemave);

<g-C>: <Graa(t)>, <grabifsèn>, <grue>, <gran>, /gj/ = <gi-A>: <ngiaa(n)>, <Giacoit>, <Ligia>; <g-E>: <mengii>.
- sikurse edhe për fonemat /k/ ~ /q/ ~ /ç/:
 

/k/ = <k-E/u/#>: <Malëkimet>, <upesckepi>, <Kiofscin>, <kiscess>, <kersctenet>, <tekersctenat>, <te keet>, <kesciiłofscin>, <me ketë pun>, <kÿ>, <ketij>, <bask>, <Kerscendełasc> krahas



<malekuem>, <kusc>, <kunaten>, <kunor>, pranë <c-u/A> :  
 <Giacoit>, <secularevet>, <decun>, <casctat>, <curr>,  
 /q/ = <ch-E>: <chi>; <chi-E>: <chieter>, <chiera>, <Turchiet>,  
 <chietercui>, <chiefsen>,  
 /ç/ = <ci-A>: <ciarten>, <ciognèn>.

### 2.3. Karakteri dialektor dhe shmangiet grafike midis varianteve shqip

Të dyja variantet e tekstit shqip dëshmojnë pa kurrfarë hezitimi bazën dialektore të gegnishtes veriperëndimore, bash atë kohë kur janë hedhur në letër. Për këtë mjafton të vëmë në dukje:

- grupin bashkëtingëllor /kj/ < \*/kl/, khs.: (4 B1, B2) <kioft>, (1 B1, B2) <kiofscin>,
- togzanorin /ue/ = <ue> që shfaqet gjithmonë i rregullt, khs.: (1 B1, B2) <malekuem>, <te huein> etj.,
- përdorimin e frikatives /f/ për /h/, khs.: (2 B1, B2) <rraffin>,
- vetën 3 nj. lidhore më {-(e)n}, khs.: (4 B1, B2) <kusc te martoin>, (5 B1, B2) <kusc të grabifscèn>, (6 B1, B2) <chi te mbaan>, (7 B1, B2) <chi te marren> etj.,
- shtesa tingujsh homorganikë të tipit: (8 B1, B2) <fambuiliiss> për \*/famullis/, (7 B1, B2) <Tempten> për \*/t'emten/, (15 B1, B2) <nta> për \*/ta/ dhe (1 B1, B2) <ngiaa> për \*/gjā/ etj.,
- Fjalëforma tipike dialektore /qetër/, /qera/ = (1 B1, B2) <chieter>, (4 B1, B2) <chiera> për të zakonshmen \*/tjetër/, \*/ tjera/

Vjetërsi dëshmojnë gjithashtu:

- ruhen qartë në shkrim fonemat /q/ = <ch> dhe /ç/ = <c(i)> (sh. lart tabelën)
- ruajtja e fonemës /nj/ në trup të fjalës (të paktën) në shkrim, khs.: (9 B1, B2) <Robigna>, <chi te ciognèn>, (12 B1, B2) <hignèn> etj.,
- shumësi i gjinoreve dhe dhanoreve të hershme në pranëvajtje me të rejat, khs.: (11 B1) <chi te ciognèn myγγεγγρ Priftene>, e me pranëvënie (12 B1) <chi mcrahe te secula | revet, ò Turchiet>, apo
- lidhoret e tipit <curr gni Prift mos te ξξeet> (< \*/tə thoetə/) etj.

### 2.4 Bashkëkohësi dhe traditë mes kodeve alfabetike të shkrimit shqip

Analizat e mësipërme gjuhësore-filologjike të tekstit shqip në var. B1 dhe B2 lejojnë tash të vlerësojmë pak a shumë me saktësi vendin e tij në kulturën e shkrimit shqip në arealin kulturor të Veriut katolik shqiptar, i cili për periudhën në fjalë (mesi i shek. të 18-të) dëshmon qartas një bashkëjetesë tri traditash shkrimi me alfabet (kryesisht)

latin,<sup>27</sup> që vijojnë në një mënyrë a një tjetër risitë e përfuara nga Budi e Bogdani në shek. e 17-të, ose të zhvilluar më tej nga Kazazi në mes të shek. e 18-të. Ndër këto tri nënsisteme ai i përdorur nga Kazazi – në mos i zbatuar vetëm prej tij, atëherë me përhapje ndoshta vetëm në pjesën verilindore të këtij areali – përbën risinë e kohës në kulturën e shkrimit shqip. Tradita e zhvilluar nga Budi kishte gjetur ndërkohë strehë ndër etërit françeskanë (të paktën) në dioqezën e Pultit. Ndërsa varianti i përdorur në tekstin tonë pasqyron vijimësi të (pa)ndërmjetshme të kodit alfabetik që përmirësoi dhe përdori Pjetër Bogdani (1685), si ipeshkëv i dikurshëm i Shkodrës.

Këtë situatë e qartëson deri diku edhe tabela e mëposhtme, ku kemi sjellë në përjasje kodin alfabetik të përdorur në tekstin tonë me ato të tri teksteve të shkurtra që trashëgojmë nga shek. i 18-të për arealin në shqyrtim, duke përfshirë në të edhe tekstin e Kazazit (1743):

IPA	Mallkimet e së Enjtes së Madhe 1704	Gj. N. Kazazi Doktr. e Kërsht. 1743	Letra e fretërve të Pultit 1761	Tubëz lutjesh (dorëshkrim) 1776
[a] ~ [a:]	a, -á ~ aa	a, à ~ aa	a ~ aa	a ~ aa
[b]	b	b, bb	b	b
[ts/dz]	z	z, *zz	z	z
[tʃ]	ci-A	ç, c-E, ci-A	c-E, -cc#	?
[d]	d	d	d	d
[ð]	ξ	ξ	ξ	ξ
[e] ~ [e:]	e, -é ~ ee	e, è ~ ee	e ~ ee	e, è ~ ee
[æ/ɜ/ə]	è, e	æ, e, e (~ ---)	(e)	è, e
[f]	f, *ff	f, ff	f	f
[g]	g-A, gh-E	g-A, gh-E, ggh	g-A, gh-E	g-A, gh-E
[j] (~ [dʒ])	g-i, gi-A	g-E, gi-A, gg	g-i, gi-A/e	ghi-A, gh-E
[h]	h	h	h	h
[i] ~ [i:]	i ~ ii, ij	i, ì, y ~ ii, ij	i ~ ii/ij	i ~ ij
[j]	i, j	j, i, y	i, j	j, i
[k]	k, c-A	k-E, c-A ch-E,	k, -kch-, c-A, ch-E	k (C)
[l]	l	*cc	l	l
[ʎ]	λ	l *ll	(?)	l
[m]	m	ll	m	m
[n]	n	m, mm	n	n
[ɲ]	gn	n, nn	gn	gn
[o] ~ [o:]	o ~ oo	gn	o (~ ?)	o, ò
[p]	p	o, ò (~ ---)	p	p
[ç]	ch(i)	p, pp	(= [tʃ])	ch
[r]	r	ch-E, chi-A, cch	r	r
[rr]	rr	r	(?)	rr
[s]	s, -fs/ss(-)	rr	s/f, -fs-	s, -ss/fs-
[ʃ]	sc/fc-E, fci-A	s, ss, f, ff, fs	sc/fc-E, fci-A, s-	sc-E, sci-A
[t]	t	sc, fc(i)-E, s/f-C	t, tt	t, *tt
[θ]	ξξ	t, tt	ξξ	ξξ

<sup>27</sup> Shih P. Bartl – B. Demiraj: Letra e fretërve të Pultit (1761) dhe vendi i saj në kulturën e shkrimit shqip në mes të shek. 18-të, në: “Hylli i Dritës” 4 [2008] 39vv.

[u] ~ [u:]	u (~ ?)	ξξ	u, v ~ uu	u ~ uu
[v]	v	u, ù ~ uu	v, u	v
[y]	ÿ ~ ÿÿ	v, u	ÿ ~ ÿÿ	ÿ ~ ÿÿ
[z]	ε	ÿ, ÿl ~ ÿÿ	ε	ε, z
		ε, *s		

### 3. Tejshkrimi diplomatik i tekstit (var. B1)

Vëzhgimet e mësipërme të grafisë së tekstit shqip në dy variantet e tij, ballafaqimi i këtyre varianteve me njëri-tjetrin dhe saktësimi i vendit të tyre në kulturën e shkrimit shqip të shek. të 18-të na lejojnë së fundi të sendërtojmë edhe qëllimin kryesor që i vumë vetes në këtë studim: botimin kritik të këtij teksti, si i fundmi që njohim deri sot për arealin kulturor të Veriut, i cili nuk u ishte nënshtruar ende parametrave të sotëm metodikë në punën filologjike me shkrimet e vjetra shqip:

#### **Mallëkimet, qi lëshon upeshkëpi t' Ejnten e Madhe**

1. Kjoftshin mallëkuem ata qi djegën shtëpīn e qetër ngjā të huejn, ende ata qi të thejn për ināt shtëpīn e huej.
2. Kjoftshin mallëkuem ata qi të rrafin gjakojt hīm ndër urdhënime.
3. Kjoft mallëkuem kush të zaptojn ngjān e kishës.
4. Kjoft mallëkuem kush të martojn biat, motrat, mbesat, sherbëtoret o qera grā jasht feje sōn.
5. Kjoft mallëkuem kush të grabisën vārzat, të vejat o qera grā, ende kush të mbahet sebet e ndim.
6. Kjoft mallëkuem ai qi të mbān dō grā.
7. Kjoft mallëkuem ai qi të marrën për grue të kunatën o t' emptën, o qetër grue, qi z' jēp Ligja.
8. Kjoft mallëkuem ai qi ns' ve kunor me prift të fambullīs mb' ate nat, qi martohet.
9. Kjoft mallëkuem ai qi shet të kērshtenēt e të kērshtenat për robinja.
10. Kjoft mallëkuem ai qi then Testamendet e çartën fjalën e tyne.
11. Kjoft mallëkuem ai qi të çonjën mōzōr priftēne.
12. Kjoftshin mallëkuem ata priftën qi m' krahē të shekullarēvet o turqet hinjën me zaptue fambullīt, ende ata qi me forc të tyne o të qetērkuj duen me mbajt o me përzan ata priftën qi të kēt vendue upeshkēpi .
13. Kjoftshin mallëkuem ato grā o vārza qi qesën barrën posht, ende ata qi këshillofshin e ndimofshin me kēte pun.

14. Kjofshin mallëkuem ata e ato qi bajn mëngjī e lidhin nierzit me kunor o për me mos bām fēmī, o për me i dām , ende ata përsērī e ato qi qesën short.
  15. Kjofshin mallëkuem ata qi tue pasun fejuem të bijn, të motrën o të mbesën për nja, dekun ky, e apën përsērī të vëllā t' këtij, o dekun vajza e fejueme për nta, t'i jëpën përsērī të motërën.
  16. Kjofshin mallëkuem ata qi dajn grāt me kunor.  
Kjoft mallëkuem ai qi të mbān o të rīsën djal e vajz të fejueme ndë shtëpī bashk.
  17. Kjoft mallëkuem kush voft në fest me gran e me pīm.]  
[—Kjoft mall(ëkuem) kush theft si ināt shtëpīn e huej, e djegt kashtat e huej.]
  18. Kjoft mallëkuem kush shet ngjān e kishës.
  19. Kjoft mallëkuem kush baft motra mbë Tenëzon. Ashtu kjoft.
- [Kujto!] Kërshëndellash kurr një priift mos të thët mesh natën, pā zbardh drita mir e mos të rrëfyejn natën, as mbasi të perandojn dielli.

### Shënime

- (1) /ngjā/ <ngiaa> „gjë“ sikurse më poshtë (3) /ngjān/ “gjënë” – variant i gjuhës së folur me një protezë joetimologjike (\*n-).  
- /qetër/ <chieter> „tjetër“ sikurse më poshtë (4) /qera/ <chiera> „tjera” – variant i gjuhës së folur me palatalizim largvajtës të grupit nistor \*tj-.
- (2) /hīm ndër urdhënime/ „që kanë marrë shugurimin (e diakonatit)”. Lexohet nga Kamsi (1958 f. 210) si /vorfënime/, duke i dhënë fjalës gabimisht kuptimin „jetimore”.
- (5) /vārz-/ alternon në tekst me një variant të palatalizuar të gjuhës së folur: (15, 16) /vajz-/.  
- /sebet/ – variant i gjuhës së folur për *sebe*p (shih Fjalori i Bashkimit 1909, f. 394).
- (7) /t' emptën/ <Tempten> “të emtën”, (Kamsi) “motra e nënës” – variant i gjuhës së folur me një shtesë epentetike (\*-p-).  
- /z' jēp/ – zëshmim dytësor i pjesëzës mohuese që “përmirësohet” në var. B2.  
/Ligja/ – e drejta kanonike kristiane.
- (8) /ns' ve/ – togu nistor *ns'* është një formë e kontaminuar e gjuhës folur, në të cilën pas gjithë gjasash janë ngjizur dy pjesëzat mohuese *nuk + s'*.
- (11) /mōzōr/ <chi te ciognèn мѡѡѡѡѡ> “mynxyrë” (shih Fjalori i Bashkimit 1909, f. 269: *mizyrë,-a*: “tirania, crudeltà”).

- /priftëne/ – fjalëformë e hershme në rasë të zhdrejtë për “priftërinjve”.
- (12) /m’ krahë të shekullarëvet o turqet/ “të mbështetur nga laikët, ose muslimanët”.
  - /turqet/ – shih (11) /priftëne/.
- (13) /qi qesën barrën posht/ – „që abordojnë, dështojnë (fëmijën)”.
- (14) /qi qesën short/ – „që hedhin fall”.
- (15) /nta/ – shih (1) /ngjë/.
- (19) /kush baft motra mbë Tenëzon/ = (var. A) /Chi facesse sorelle giurate/ – Interpretim i vështirë e krejt i paqartë për shkruesin e këtyre radhëve. Kamsi (1958 211) përsiat këtu kuptimin “probateshë, motërmë (duke bërë be e pirë gjak)”. Sillet si aluzion edhe episodi biblik i dyshimit të motrave të Shën Vasilit ndaj fuqive shëruese të Jezu Krishtit (kumtim nga Matteo Mandalà dhe Tefë Topalli) ose ndalesa që i bëhet me kanun femrës për të ushtruar benë si akt kanunor-juridik (kumtim nga Italo Sarro).



11.  
12  
13  
14
- I* scomunicati nel Giovedì Santo. ————
- I. Gli Incendiarij. ————
  - II. I percussori dei Chierici. ————
  - III. Chi occupa gli beni Ecclesiastici. ————
  - IV. Chi marita le figlie, sorelle, nipoti, serve, o altre femi-  
ne con gli Infedeli. ————
  - V. I Mattoni delle zitelle, vedove, & altre femine. Et i loro  
fautori. ————
  - VI. Quello, che nello stesso tempo tiene due donne. ————
  - VII. Chi pigliasse, o tenesse la cognata, zia &c. ————
  - VIII. Chi non contrae il Matrimonio in faccia Ecclesie subito  
presa la sposa. ————
  - IX. Chi vende i Christiani, & le Christiane per schiave. &c. ————
  - X. Chi rompe il Testamento. &c. ————
  - XI. Chi cita al Tribunale secolare gli Ecclesiastici. ————
  - XII. Quei Sacerdoti, che col braccio de' secolari, o Turchi s'in-  
troducono nelle Parrocchie, e quelli, che con le sue  
forze, e degl' altri impediscono il Prelato volendo tratte-  
ner, o scacciar i Sacerdoti luogati da lui. ————
  - XIII. Quelli, et quelle, che fanno fattucherie per impedire  
la copula matrimoniale, o per non haver prole, o per  
separar i congiunti &c. come pure quelli, et quelle, che van-  
no ad indovinare. ————
  - XIV. Quelle donne, o zitelle &c. procurano l'aborto, e chi le  
favorisce, consigliape, & aiutape &c. ————
  - XV. quelli =



- XV. Quelli, che havendo fidata la figlia, sorella, o Nepote &c. per uno, morto questo la danno al Fratello di questo, o pure morta quella, a cui è stata fidata li si dà la sorella.
- XVI. Quelli, che abbandonano la moglie legittima, e ne pigliano un'altra illegittimamente. &c.
- XVII. I bagordi, e le mangierole nelle feste delle proprie Chiese.
- XVIII. I Simoniaci &c.
- XIX. Chi rompesse per dispetto la Casa altrui, o abbruggiasse i fienii.
- XX. Chi facesse sorch. Amen.
- XXI. Le Scivate. — Nunc fuoco celebrata la messa di Natale <sup>avanti</sup> spuntato il Sole, o il giorno

In Albanese.

- Madekimet, chi lesion yvekkepi Teinten Enaze.
- 1. Kiofsein madekuam atà, chi dieghen setepiin, e chietter ngiaan te hucin, ende atà, chi te <sup>te</sup>ein per inaat setepiin e hucin.
- 2. Kiofsein madekuam atà, chi te vraffin Giacoit kiim nder vrganime.
- 3. Kioft madekuam kuse te eaptoin ngiaan e kisoets.
- 4. Kioft madekuam kuse te martoin Biat, motvat, mbessat, Oerbetoret, o chiera Graa jastet Feje soon.
- 5. Kioft madekuam kuse te grabissin vaaveat, tevejat, o chiera Graa, ende kuse te mbahet sebet, e ndim.
- 6. Kioft madekuam ai, chi te mbaan d'os Graa.
- 7. Kioft madekuam ai, chi te marren per Gruo te bunaton o Tempten, o chietter Gruo, chi eicep Ligia son.
- 8. Kioft=



16 | ~~ma... chiesa.~~

17 | ~~Kioft maktekuen... note non... gran,~~  
e me... ~~...~~

~~Kioft maktekuen... inas... e... e...~~

18 | Kioft maktekuen... sect... e...

19 | Kioft maktekuen... Kioft...  
Kase bastmotra mbe... Kioft.

20 | ~~...~~

**SINODO DI MONSIGNOR ANTONIO BABBI**

**Vescovo di Scutari.**

*N. di S. Marco - 1704 - in Belograd di Scutari.*

**Le** *Constituzioni, e Secreti fatti dal Monsig. Ant. Babbì Vescovo di Scutari nel Sinodo alli Parochi della sua Diocesi per servizio vivo, & frutto spirituale dell' anime Christiane sedente col pretioso sangue di Gesù Christo nostro Sig. commesse alla loro cura, & zelo.*

*Nell' Ufficio della Parochia.*

*Eloro Ufficio particolare d'invigliare, d'affaticarsi, e di sudare sopra tutte le cose nella vigina del loro Sudio. Onde comandiamo sud noi Ant. Babbì Vescovo di Scutari a tutti i Parochi nostri Diocesani, che non debbono pernottare fuori della loro Parochia più d'una notte acciò per loro negligenza non muoja qualche Cattolico senza il beneficio della Confessione, & del sac. Viatico, dell' estrema unzione, et anco qualche fanciullo senza Battesimo dove non v'è altro compagno.*

*Nelli giorni di Domenica, ed altri festivi non lascino la loro*



(H) U

Lairkimet, chi kumon Upereshopi i Eten Emaze

1. Kieftin m'adekuembi d'eghin k'epin, e chietor q'jan te kumon, vade ato, chi te q'jan per v'uat datapira e t'uei
2. Kieftin m'adekuemata, e te v'afjen v'acit h'um ider ur'umet.
3. Kieftin m'adekuembi k'ise te d'aptan, v'egnan e k'isein
4. Kieftin m'adekuembi k'ise te martan, biat, v'atout, m'hesat, v'atout e k'chiera graa jaset i'ep san
5. Kieftin m'adekuembi k'ise te grabitan v'atout, temjat e k'chiera graa
6. Kieftin m'adekuembi k'ise te m'baan v'atout
7. Kieftin m'adekuembi k'ise te m'arion per q'nie te kumaten e templa e chietor q'nie chi v'egnan Lyca
8. Kieftin m'adekuembi k'ise te m'arion me k'ist te Jambuditta m'at'iat, chi m'at'iat
9. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
10. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
11. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
12. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
13. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
14. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
15. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
16. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
17. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist
18. Kieftin m'adekuembi k'ise te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist, e te k'ist te k'ist

## Abstract

### **The curses uttered by the Bishop on Holy Thursday (1744?)**

This essay begins with a summary of how the 18-century Albanian text of the *Curses* was discovered and the extent to which researchers have been engaged so far in studying it. The willingness to join them is primarily related to the wish for an authentic philological analysis of the text, the only text of the Catholic-influenced culture area of the North. Moreover, this area is not yet subject of today's methodological parameters for philological studies on Early Albanian writings.

Such analysis undoubtedly allowed us to evaluate the importance of this manuscript to the history of written Albanian. On the other hand, analysing in depth and interpreting manuscripts of the Central State Archive in Albania (AQSH) have now made possible to participate actively in the debate on the true date and authorship of the *Curses*.